



LISTA E BORXHLINJVE NR.08/2022 PËR BORXHE TË VONUARA DERI MË 30.04.2022 DHE TË PAPAGUARA DERI MË 31.04.2022

Drejtoria e të Ardhurave Publike publikon Listën e borxhlinjve nr. 08/2022 për borxhe të vonuara deri më 30.04.2022 dhe të papaguara deri më 31.07.2022 në bazë të TVSH-së, tatimit të fitimit, tatimit personal të fitimit, kontribute nga sigurimi i obligueshëm social, akciza dhe dogana, për të cilat shuma totale e borxhit është:

1. Më e lartë se 120.000 denarë për personat fizik dhe kryerësit e veprimtarive të parvarura
2. Më e lartë për 300.000 denarë për personat fizik

Lista e borxhlinjve publikohet në web faqen e Drejtorisë së të Ardhurave Publike në pajtim me nenin 9 nga [Ligji për procedurë tatimore](#).

Drejtoria e të Ardhurave Publike, pa pëlqim të obliguesit tatimor mund të publikojë në web faqen e saj të dhëna për shkak të korigjimit të informatave jo të plota të cilat janë të publikuara në Listën e borxhlinjve.

Nëse obliguesi tatimor nuk pajtohet me të dhënat e publikuara, Ju lutemi të drejtoheni der te:

- Drejtoria Regjionale e DAP e cila është kompetente (shih kontaktet) – për borxhet e publikuara në bazë të TVSH-së, tatimit të fitimit, tatimit personal dhe kontributet nga sigurimi i obligueshëm social.
- Drejtoria Doganore e RMV – Departamenti për pagesë të të ardhurave, buxhet, garanca dhe analiza (tel. 02/3293 978 apo 02/ 3293 971) – për borxhet e publikuara në bazë të akcizave, doganat dhe TVSH gjatë importit.

Në listën e borxhlinjve nr. 08/2022 janë publikuar 1.677 borxhlinjë – persona juridik (për 39 më shumë se në listën e mëparshme) dhe 3.197 persona fizik (për 15 më shumë se në listën e mëparshme)
Neto borxhi total i publikuar në Listën nr. 08/2022 është 8.254.991.737 denarë, për 41.180.990 denarë më pak nga Lista e mëparshme
Neto borxhi për tatime dhe të ardhura është 8.031.308.102 denarë (më pak për 209.465.341 denarë nga lista e mëparshme), përderisa borxhi për shpenzime doganore është 223.683.635 denarë (për 168.284.351 denarë më shumë se në listën e mëparshme).